



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.9**

**15 shkurt**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 212 datë 21.1.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar”.....	293
Ligj nr.10 213 datë 21.1.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave e të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro-malazez”.....	301
Ligj nr.10 214 datë 21.1.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat”.	306
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Alket Latollari.	320

**LIGJ**  
**Nr.10 212, datë 21.1.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR  
BASHKËPUNIMIN POLICOR NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6390, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR  
NDËRKUFITAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (më poshtë: Palët),

*duke respektuar* marrëdhënien miqësore ndërmjet shteteve;

*duke marrë parasysh* legjislacionet kombëtare dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare të të dyja shteteve;

*me synim* intensifikimin e marrëdhënieve dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërkufitar;

*duke theksuar* rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar për sigurinë e brendshme dhe stabilitetin e rendit publik dhe ligjit;

*me synim* për të vepruar me më shumë efikasitet me anë të masave të përbashkëta, planeve dhe veprimeve, kundër migracionit të paligjshëm, trafikut të qenieve njerëzore dhe formave të tjera të krimit ndërkufitar;

*në përpjekje* për të lehtësuar qarkullimin ndërkufitar në nivelin më të mirë të mundshëm; ranë dakord si më poshtë:

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### **Objekti i marrëveshjes**

Sipas kësaj marrëveshjeje dhe legjislacioneve të tyre kombëtare, palët kontraktuese forcojnë bashkëpunimin midis institucioneve dhe autoriteteve kompetente kufitare për të parandaluar rrezikun dhe për të siguruar rendin publik në zonat kufitare dhe veçanërisht për të parandaluar dhe zbuluar shkeljet penale (tani e tutje: parandalimi i krimit ndërkufitar) dhe shkelje që cenojnë sigurinë kufitare, duke respektuar njëkohësisht legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e brendshme të secilës palë dhe vetë marrëveshjen.

### Neni 2

#### **Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është:

- forcimi i sigurisë në kufirin e përbashkët shtetëror;
- parandalimi më efikas i migracionit të paligjshëm;
- parandalimi më efikas i krimit ndërkufitar;
- parandalimi gjithëpërfshirës i rreziqeve të tjera kundër sigurisë publike;
- lehtësimi i procedurave në kontrollin e kalimit të kufirit;
- forcimi i bashkëpunimit në kufirin e përbashkët shtetëror.

### Neni 3

#### **Institucionet dhe autoritetet kompetente**

1. Institucionet dhe autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë:

Në Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Institucionet e tjera të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit (doganat, shërbimi fito-sanitar dhe shërbimi veterinar).

Në Republikën e Kosovës:

Ministria e Punëve të Brendshme

Drejtoria e Policisë Kufitare

2. Palët kontraktuese informojnë në mënyrë reciproke njëra-tjetrën për ndryshimet në lidhje me institucionet dhe autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. Institucionet dhe autoritetet kompetente informojnë drejtpërsëdrejti njëra-tjetrën për kompetencat e secilës palë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes.

## BASHKËPUNIMI I PËRGJITHSHËM

### Neni 4

#### **Bashkërendimi i veprimtarive policore**

Me qëllim përmirësimit të efikasitetit të bashkëpunimit në kuadrin e kësaj marrëveshjeje autoritetet policore të palëve angazhohen:

- të informojnë njëra-tjetrën për çështje pune që fokusohen në parandalimin e krimit ndërkufitar, ashtu si edhe për masa të rëndësishme të ndërmarra për të mbrojtur kufirin shtetëror ose për të kontrolluar trafikun ndërkufitar dhe që mund të kenë ndikim në interesat e palëve kontraktuese;

- të caktojnë organe ose persona bashkërendues për të luftuar krimin e organizuar në zonën kufitare;
- të hartojnë analiza të përbashkëta të problemeve ndërkufitare dhe bëjnë plane për veprimtari operacionale brenda zonave kufitare;
- të kryejnë veprimtari të bashkërenduara dhe të harmonizuara përgjatë kufirit të përbashkët shtetëror.

#### Neni 5

### **Komunikimi dhe lidhja e telekomunikacionit reciprok**

1. Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, institucionet dhe autoritetet kompetente mund të përmirësojnë komunikimin reciprok me anë:

- të emërimit të oficerëve të kontaktit që kanë njohurinë e duhur për palën tjetër;
- të dërgimit afatshkurtër të ekspertëve në territorin e palës tjetër me kërkesë të veçantë shtesë;
- të vizitave reciproke të studimit nga ekspertët;
- të shkëmbimit të informacionit mbi lidhje të rëndësishme telekomunikacioni dhe adresa e-mail të institucioneve dhe autoriteteve kompetente.

2. Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, institucionet dhe autoritetet kompetente mund të përmirësojnë lidhjet e telekomunikacionit reciprok me anë të:

- sigurimit të lidhjes së drejtpërdrejtë për transferimin e të dhënave në formë grafike, fotografike dhe videove;
- bashkëpunimit për të siguruar funksionim të rregullt të sistemit policor të radiove;
- të krijimit të lidhjeve me radio në frekuencat e rëna dakord në rast të nevojave të veçanta.

#### Neni 6

### **Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve**

1. Institucionet dhe autoritetet kompetente shkëmbejnë informacion të rëndësishëm në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht informacion mbi:

- shkelje penale të kryera brenda zonave kufitare, personat e dyshuar si shkelës apo bashkëpunëtorë, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së shkeljes penale dhe masat e marra;
- persona dhe objekte në kërkim;
- fenomenin e ri të krimit në kufi;
- ngjarje dhe veprimtari të ngjashme reciproke për sigurinë në zonën kufitare;
- literaturën e fundit dhe çështje teknike të ekspertizës dhe biznesit, që është i rëndësishëm për bashkëpunimin sipas kësaj Marrëveshjeje;
- legjislacionin aktual kombëtar dhe rregullore të tjera të palëve, në lidhje me lëndën e kësaj Marrëveshjeje, si edhe ndryshimeve të tyre.

2. Institucionet dhe autoritetet kompetente të palëve, në datat e rëna dakord, shkëmbejnë informacion të rëndësishëm për shtjellimin e analizave të përbashkëta të rrezikut për problemet e sigurisë brenda zonës kufitare.

#### Neni 7

### **Përdorimi i pajisjeve të veçanta**

1. Institucionet dhe agjencitë përgjegjëse të palëve, sipas kësaj Marrëveshjeje apo marrëveshjeve shtesë, me synim përmirësimin e efikasitetit të bashkëpunimit, në përputhje me mundësitë, mund të përdorin, përkohësisht dhe pa rimbursim financiar, pajisje dhe mjete të veçanta policore të palës tjetër.

2. Pajisje apo mjete përdoren nga eksperti i palës që i posedon ato. Pajisjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nuk kërkojnë licencë të veçantë importi dhe eksporti, detyrim, taksë, kur hyjnë dhe dalin nga territoret respektive.

## Neni 8

### **Arsimimi, trajnimi dhe trajnimi i avancuar**

Palët mund të vendosin bashkëpunim gjithashtu brenda fushës së arsimimit, trajnimit dhe trajnimit të avancuar, veçanërisht me anë:

- të shkëmbimit të përvojës dhe informacionit mbi metodat dhe format e punës policore;
- të takimeve të përbashkëta të punës;
- të trajnimit të specializuar në nivel ekspertësh;
- të pjesëmarrjes së ekspertëve gjatë stërvitjeve;
- të shkëmbimit të trajnuesve.

## Neni 9

### **Ndihma në aksidente dhe katastrofa natyrore dhe civile**

1. Institucionet dhe agjencitë përgjegjëse të palëve mund të ofrojnë asistencën reciproke në aksidente dhe katastrofa natyrore dhe civile, që ndikojnë në gjendjen e sigurisë në territorin shtetëror të palës tjetër, në mënyrë të tillë që:

- a) kur është e mundur, menjëherë, informojnë në mënyrë reciproke njëra-tjetrën për këto ngjarje dhe njohurinë në lidhje me to;
- b) ndërmarrin dhe bashkërendojnë me palën tjetër veprime dhe masa të nevojshme policore në lidhje me to;
- c) me kërkesë të palës në territorin e së cilës ka ndodhur katastrofa, japin ndihmë brenda kuadrit të kapaciteteve reale, përkatësisht duke dërguar ekspertë ose duke siguruar apo dhënë pajisje dhe mjete.

2. Në rastet e paragrafit 1 pika “c”, kufiri mund të kalohet nëse është e nevojshme që kjo të bëhet menjëherë dhe në vend apo jashtë pikave të kalimit kufitar dhe jashtë orarit të punës. Në këtë rast, oficerët duhet t’i binden të njëjtave rregulla, ashtu si edhe oficerët lokale.

### **FORMA TË VEÇANTA TË BASHKËPUNIMIT POLICOR NDËRKUFITAR**

## Neni 10

### **Caktimi i pikave të kontaktit ndërmjet policive kufitare**

1. Çdo palë kontraktuese, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të caktojë pikën e saj të kontaktit me autoritetet e policisë kufitare të palës tjetër kontraktuese.

2. Pika e kontaktit do të funksionojë në zbatim të protokollit të posaçëm që palët do të nënshkruajnë “Për vendosjen dhe funksionimin e pikës së kontaktit në mes policive kufitare”.

## Neni 11

### **Organizimi dhe kryerja e takimeve në nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale në mes drejtuesve të policive kufitare**

1. Çdo palë kontraktuese, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të organizojë dhe zhvillojë takime në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal në mes drejtuesve të policive kufitare.

2. Procedura e organizimit dhe kryerjes së takimeve në të tri nivelet, do të përcaktohet në protokollin e posaçëm që palët do të nënshkruajnë “Për organizimin dhe zhvillimin e takimeve në tri nivelet në mes drejtuesve të policive kufitare”.

3. Nëse është e nevojshme, autoritetet policore të palëve kontraktuese mund të krijojnë grupe të veçanta pune në të gjitha nivelet, për kryerjen e detyrave të veçanta policore dhe për të zgjidhur incidente kufitare apo cenime të kufirit shtetëror. Persona zyrtarë të Autoritetit Policor të një pale kontraktuese mund të veprojnë në territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese duke dhënë këshilla ose duke dhënë ekspertizë për çdo kërkesë.

## Neni 12

### **Vendosja e oficerëve për ndërlidhje**

1. Çdo palë kontraktuese, sipas kësaj Marrëveshjeje, mund të caktojë oficer ndërlidhës në territorin shtetëror të palëve kontraktuese.

2. Oficeri ndërlidhës në territorin e palës tjetër kontraktuese vepron vetëm duke dhënë këshilla dhe shkëmbyer informacion, si dhe duke kryer detyra të tjera brenda kuadrit të udhëzimeve të veçanta të palëve kontraktuese.

Procedurat e vendosjes dhe funksionimit të oficerëve ndërlidhës, do të përcaktohen në marrëveshjen e posaçme që palët do të nënshkruajnë “Për vendosjen e oficerëve ndërlidhës”.

3. Oficerët e policisë, të cilët, njëra prej palëve kontraktuese, i dërgon në një vend të tretë, me marrëveshje të autoriteteve policore kompetente të palëve kontraktuese, mund të përfaqësojnë interesat e palës tjetër kontraktuese.

## Neni 13

### **Patrullime të përbashkëta përgjatë kufijve shtetërorë**

Autoritetet policore të palëve kontraktuese, në bazë të protokollit të veçantë “Për patrullimin e përbashkët në kufi”, me synim parandalimin e rrezikut për rendin publik, lufta kundër të gjitha formave të krimit dhe nivelit në të mirë të mbikëqyrjes së kufirit shtetëror, mund të bien dakord për vendosjen e patrullave të përbashkëta të policive kufitare dhe agjencive të tjera që operojnë në kufi.

## Neni 14

### **Ndërtimi e funksionimi i pikave të kalimit kufitar të përbashkëta**

Palët kontraktuese, në bazë të marrëveshjeve të posaçme “Për ndërtimin e funksionimin e pikave të kalimit kufitar të përbashkëta” me synim realizimin e objektivave për përmirësimin e infrastrukturës së transportit rajonal dhe europian, për të thjeshtësuar dhe lehtësuar kryerjen e veprimeve në lidhje me kontrollin kufitar në trafikun e kalimit kufitar midis shteteve, mund të bien dakord për ndërtimin dhe funksionimin e pikave të kalimit kufitar të përbashkëta.

## Neni 15

### **Ndërtimin dhe funksionimin e zyrave të përbashkëta për shkëmbim të menjëhershëm të informacionit**

Në territorin e njëres prej palëve kontraktuese, sipas protokollit të posaçëm “Për ndërtimin dhe funksionimin e zyrave të përbashkëta për shkëmbim të menjëhershëm të informacionit” palët bien dakord, për kohësisht apo përgjithmonë, për krijimin e ambienteve të përbashkëta zyrtare, ku persona zyrtarë të institucioneve dhe autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese do të shkëmbejnë dhe analizojnë informacionin me interes të përbashkët mbi bashkëpunimin ndërkufitar.

## Neni 16

### **Shkëmbimi i të dhënave dhe analiza e përbashkët e rrezikut**

Autoritetet policore të palëve kontraktuese, në bazë të protokollit të veçantë “Për shkëmbimin e të dhënave të analizës së rrezikut”, me synim parandalimin e rrezikut për rendin publik në të dy anët e kufirit dhe më gjerë, luftën kundër të gjitha formave të krimit dhe vendosjes së nivelit më të mirë të menaxhimit të integruar të kufirit shtetëror, mund të bien dakord për shkëmbimin e të dhënave të analizës së përbashkët të rrezikut sipas procedurave të parashikuara në protokoll.

## Neni 17

### **Organizimi dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta në kufi**

Autoritetet policore të palëve kontraktuese, në bazë të protokollit të veçantë, me synim harmonizimin e veprimeve të përbashkëta dhe rritjen e forcës goditëse ndaj aktiviteteve të paligjshme në kufi, mund të bien dakord për organizimin dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta në kufi, sipas procedurave të parashikuara në protokollin e posaçëm “Për organizimin dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta në kufi”.

## Neni 18

### **Planifikimi dhe kryerja e hetimeve të përbashkëta**

1. Me synim përbushjen e detyrave për menaxhimin e integruar të kufijve, nëse është e nevojshme, palët krijojnë grupe të përbashkëta pune hetimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të policisë kufitare dhe ekspertë të posaçëm.

2. Procedurat e planifikimit dhe kryerjes së hetimeve të përbashkëta, do të përcaktohen në protokollin e posaçëm që palët do të nënshkruajnë “Për organizimin dhe zhvillimin e hetimeve të përbashkëta në kufirit shtetëror”.

## MARRËDHËNIET LIGJORE

## Neni 19

### **Pozicionet dhe autoritetet ligjore ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese**

1. Autoritetet kompetente të personave zyrtarë të Agjencisë Policore të përmendur në nenin 3, të cilët brenda kuadrit të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje, veprojnë në territorin sovran të palës tjetër kontraktuese, kanë të bëjnë vetëm me autoritetet që janë krijuar dhe parashikuar nga kjo Marrëveshjeje.

2. Në zbatimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave, veprimeve dhe procedurave, duhet të respektohet rreptësisht legjislacioni në fuqi i palës tjetër kontraktuese.

3. Personat zyrtarë të specifikuar në paragrafin e parë të këtij neni autorizohen:

- të veshin uniformën e tyre zyrtare dhe të mbajnë armë dhe mjete të tjera shtesë, që lejohen sipas ligjit të palës tjetër kontraktuese, përveçse nëse autoritetet ligjore të përmendura në nenin 3 informojnë që e lejojnë, ose nuk lejojnë nën rrethana të caktuara;

- të përdorin armë zyrtare në rast të vetëmbrojtjes së pashmangshme në territorin e palës tjetër kontraktuese;

- të hyjnë në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe qëndrojnë pa vizë apo dokument udhëtimi, në distancën 10 km/milje nga kufiri shtetëror gjatë kryerjes së detyrës sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse kanë dokument identifikimi zyrtar me fotografi dhe nënshkrim;

- të përdorin automjete dhe mjete lundruese të autoriteteve të tyre policore. Në këtë rast, personat zyrtarë janë të detyruar të respektojnë rregulloret e trafikut të palës, në territorin e së cilës qëndrojnë.

4. Nëse është e nevojshme, me qëllim që të kryhen detyrat, sipas kësaj Marrëveshjeje, personat zyrtarë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, mund të kalojnë kufirin shtetëror jashtë pikave të kalimit kufitar.

5. Çdo palë kontraktuese është e detyruar të mbrojë, përveç oficerëve të vet dhe oficerët e palës tjetër kontraktuese që janë dërguar zyrtarisht në territorin e saj.

6. Marrëdhëniet e barabarta të personave zyrtarë, përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, rregullohen sipas legjislacionit në fuqi të palëve kontraktuese.

7. Personat zyrtarë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, për veprimtaritë e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, në territorin sovran të palës tjetër kontraktuese nuk kanë nevojë për leje të veçantë për të vepruar. Mjaftojnë përcaktimet e bëra në marrëveshje dhe në protokolle.

## Neni 20

### **Përfshirja e detyrimeve dhe taksave të tjera**

Të gjitha objektet, automjetet motorike dhe lundruese zyrtare, ashtu si dhe objektet për përdorim personal, të cilat hyjnë apo dalin nëpër pikat e kalimit të kufirit, nga persona zyrtarë të agjencive policore, të cilët brenda kuadrin të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje gjatë kryerjes së detyrave funksionale veprojnë në territorin sovran të palës tjetër kontraktuese, përfshihen nga leja të veçanta, detyrime, taksa, TVSH, taksa porti dhe taksa të tjera kufitare.

## Neni 21

### **Detyrimi për kompensim të dëmit**

1. Palët kontraktuese në mënyrë reciproke heqin dorë nga të gjitha të drejtat për të pretenduar kompensim të dëmit që rezultojnë në humbje apo dëmtim pasurie, që u përket atyre, nëse dëmi shkaktohet nga personi zyrtar i autoriteteve policore nga neni 3, në rastin e kryerjes së detyrave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët kontraktuese në mënyrë reciproke heqin dorë nga të gjitha të drejtat për të pretenduar kompensim të dëmit në rast dëmtimi apo vdekjeje të personit zyrtar, sipas nenit 3, nëse dëmtimi apo vdekja u shkaktohet nga kryerja e detyrave, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Në këto kushte, nuk ekziston e drejta për të paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit të oficerit apo anëtarëve të familjes së tij.

3. Nëse personi zyrtar i autoriteteve policore sipas nenit 3, të një palë kontraktuese në kryerjen e detyrave në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje i shkakton një dëm personit të tretë, pala kontraktuese, në territorin e së cilës u shkaktohet dëmi, është përgjegjëse për dëmin e shkaktohet sipas rregullave ligjore të zbatuara nëse dëmi është shkaktohet nga oficeri i tyre.

4. Pala kontraktuese, personi zyrtar i të cilës shkaktoi dëmin, kompenson palën tjetër kontraktuese me shumën e plotë, që ajo palë kontraktuese pagoi atë që vuajti një dëm apo pasardhësin e tij ligjor.

5. Autoritetet kompetente policore të palëve kontraktuese bashkëpunojnë ngushtë me qëllim që të lehtësojnë kërkesat për kompensim të dëmit. Në këtë rast, ato shpërndajnë të gjithë informacionin e mundshëm për veprime dëmshpërbluese sipas këtij neni.

6. Parashikimet e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse dëmi shkaktohet qëllimisht apo nga pakujdesia e dukshme dhe jashtë ushtrimit të detyrave zyrtare.

## Neni 22

### **Detyrimi brenda fushës të së drejtës penale**

Nëse personat zyrtarë, sipas nenit 3, në kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me marrëveshjen, kryejnë shkelje penale në territorin e secilës palë, nëse shkelja penale është kryer kundër tyre, ata janë të barabartë si në të drejta, ashtu edhe përgjegjësi me personat zyrtarë të palës tjetër kontraktuese.

## Neni 23

### **E drejta për të mos bashkëpunuar dhe detyrime të tjera**

Nëse një palë kontraktuese mendon që procedimi sipas kërkesës apo aplikimit të palës tjetër në lidhje me zbatimin e detyrimeve specifike të kësaj Marrëveshjeje mund të rezultojnë në rrezikimin e sovranitetit, sigurisë apo interesave të tjerë të rëndësishëm ose mund të jetë kundër rregullave ligjore, mund të refuzojë kërkesën pjesërisht ose krejtësisht ose ta kushtëzojë me kushte të veçanta.



Neni 24  
**Mbrojtja e të dhënave**

1. Duke marrë parasysh parimet e konventës “Për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Strasburg 28 janar 1981) dhe rekomandimet nr. R 87 (15) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare, që rregullojnë përdorimin e të dhënave personale në sektorin policor (Strasburg, 17 shtator 1987), autoritetet kompetente policore të palëve kontraktuese, përcaktojnë kushtet e tjera për mbrojtjen e të dhënave personale që shkëmbehen brenda kuadrit të bashkëpunimit.

2. Çdo informacion i mbledhur dhe dokumentuar nga autoritetet policore nuk mund t’u vihet në dispozicion ose t’u bëhet e ditur shteteve të treta pa miratimin e palëve kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje.

3. Mbrojtja e fshehtësisë së dokumentacionit, informacionit dhe mjeteve policore që i janë dhënë apo dërguar palës tjetër kontraktuese do të bëhet sipas rregullave kombëtare ose do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë.

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 25  
**Zbatimi i formave speciale të bashkëpunimit**

1. Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Kufitare në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të nënshkruajnë marrëveshje të posaçme ose protokollet për zbatimin e formave speciale të bashkëpunimit policor ndërkufitar sipas neneve 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje, dhe nëse është e nevojshme, mund të nënshkruajnë protokoll për zbatimin e formave të tjera të parashikuara të bashkëpunimit, sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Organet kompetente policore, sipas paragrafit 1 të këtij neni, informojnë në mënyrë reciproke njëra-tjetrën mbi të gjitha rrethanat e rëndësishme në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Mosmarrëveshjet, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen nëpërmjet kontakteve direkte të autoriteteve respektive të dy palëve kontraktuese: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Kufitare e Republikës së Kosovës.

2. Nëse mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen nga autoritetet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, ato do të zgjidhen me rrugë diplomatike.

Neni 27  
**Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe do të zbatohet 30 ditë pas marrjes së notës së fundit diplomatike, me anë të së cilës palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore. Çdo palë kontraktuese mund ta anulojë Marrëveshjen në çdo moment me shkrim, në rrugë diplomatike. Anulimi hyn në fuqi 3 muaj pas marrjes nga pala tjetër të njoftimit për anulim.

3. Secila palë kontraktuese përkohësisht, pjesërisht apo krejtësisht, mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Është e nevojshme që të informojë menjëherë palën tjetër kontraktuese për pushimin e pezullimit, me shkrim, me rrugë diplomatike.

Nënshkruar në Prishtinë, më 6.10.2009, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, në formën e tillë që të gjitha tekste janë autentike me origjinalin. Në rast mosmarrëveshjeje për shpjegimin e tekstit të marrëveshjes, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

## **LIGJ**

**Nr.10 213, datë 21.1.2010**

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR RIPARIMIN, RINDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E PIRAMIDAVE E TË SHENJAVE TË TJERA KUFITARE NË KUFIRIN SHTETËROR SHQIPTARO-MALAZEZ”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave e të shenjave të tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro-malazez”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6391, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

#### **MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR RIPARIMIN, RINDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E  
PIRAMIDAVE E SHENJAVE TË TJERA KUFITARE NË KUFIRIN SHTETËROR SHQIPTARO-  
MALAZEZ**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (më poshtë të quajtura palë),

*më dëshirën* e mirë që të rregullohen me marrëveshje të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe riparimin e piramidave kufitare ekzistuese, piramidave të ndërmjetme dhe shenjave të tjera kufitare;

*me qëllim* mbajtjen e vijës së kufirit në gjendje të dallueshme, që të evitohet çdo shkak mosmarrëveshjeje në kufirin shtetëror të përbashkët;

*duke vënë* theksin në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis dy vendeve, ranë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Kufiri shtetëror shqiptaro-malazez është vendosur gjatë viteve 1922-1925 dhe konfirmuar me protokollin e Firences të datës 26 korrik 1926, si dhe është e shënuar në mënyrë të dukshme gjatë viteve 1954 dhe 1955 me piramida kufitare, piramidat e ndërmjetme, shenja notuese, ndriçonjëse e shenja të tjera kufitare në bazë të marrëveshjes së nënshkruar më 11 dhjetor 1953 midis Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe RSF të Jugosllavisë.

Për të lehtësuar mirëmbajtjen dhe riparimin e piramidave kufitare, piramidave të ndërmjetme dhe shenjave të tjera kufitare, kufiri shtetëror shqiptaro-malazez është ndarë në tri seksione kufitare A1, A2 dhe B, siç është vendosur gjatë viteve 1922-1925 nga Komisioni Ndërkombëtar, dhe konkretisht:

Seksioni A1 fillon prej kufirit të ujërave tokësore në detin Adriatik, deri në bregun veriperëndimor të liqenit të Hotit, në pjesën verilindje të liqenit të Shkodrës, piramida A1-11.

Seksioni A2 fillon prej pikës në bregun veriperëndimor të liqenit të Hotit, piramida A1-11 deri te pika trigonometrike me kuotë 2093 të malit të Vilës, piramida A2-27.

Seksioni B fillon prej pikës trigonometrike 2093 të malit të Vilës, piramida A2-27 deri te kuota 2366 (në jugperëndim rreth 100 m), piramida B-28/4 (kufiri tresh Shqipëri-Mali i Zi-Kosovë).

#### Neni 2

Të dy palët kontraktuese zotohen se do t'i ruajnë të gjitha piramidat kufitare të ndërmjetme dhe shenjat e tjera kufitare pa dallim të seksioneve kufitare dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e çdo dëmtimi, zhdukjes ose zhvendosjet e tyre nga shtetasit e vet.

#### Neni 3

Palët kontraktuese zotohen se do të mirëmbajnë dhe do të rindërtojnë të gjitha piramidat kufitare të ndërmjetme dhe shenjat e tjera kufitare, me anën e të cilave është përcaktuar kufiri shtetëror shqiptaro-malazez dhe do të përballojnë të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga këto detyrime, si më poshtë:

a) Republika e Shqipërisë në seksionet kufitare A1 dhe A2 nga derdhja e lumit të Bunës deri te pikat trigonometrike 2093 mali i Vilës, piramida A2-27.

b) Mali i Zi në seksionin B nga pika trigonometrike 2093 mali i Vilës, piramida A2-27 deri te kuota 2366 (jugperëndim rreth 100 m), piramida-B 28/4 në kufirin shtetëror Shqipëri-Mali i Zi-Kosovë.

Në qoftë se dëmtimi ose zhdukja e piramidave të mëdha, piramidave të vogla dhe shenjave të tjera kufitare bëhet për faj të shtetit kontraktues, i cili nuk është i detyruar që të kujdeset për këtë seksion kufitar ose nga persona që vijnë nga territori i palës tjetër që nuk kujdeset për ruajtjen e atij seksioni kufitar, të gjitha shpenzimet për riparimin, rindërtimin bien mbi palën kontraktuese tjetër që i përket personit (shtetasit) ose nga territori i së cilës vjen personi që shkakton dëmtimin e piramidës ose të shenjave të tjera kufitare. Përgjegjësia përcaktohet bashkërisht në vendin e ngjarjes nga ana e të dy palëve.

#### Neni 4

Përsa i përket ruajtjes dhe përcaktimit të vijës kufitare në rrjedhjet e ujërave (shtratit të lumit ose përroit), të dy palët kontraktuese ranë dakord që edhe më tej të veprohet në bazë të nenit 5 të protokollit të Firences, të vitit 1926, sipas të cilit në rast se uji ndryshon rrjedhjen e tij, si pasojë e veprimeve natyrore dhe të ngadalshme të ujërave, vija kufitare do të ndjekë këtë ndryshim d.m.th. do të ndjekë edhe më tej mesin e rrjedhjes së ujit (thalëegu), kurse në rast se ndryshimi i rrjedhjes së

ujit shkaktohet në mënyrë artificiale ose nga një veprim i papritur i fuqive të natyrës, vija kufitare do të mbetet e qëndrueshme dhe e pandryshueshme.

Palët kontraktuese zotohen se të gjitha punimet hidroteknike eventuale në lumenjtë e përrrenjtë kufitarë që mund të influencojnë në ndryshimin e rrjedhjes së ujit do t'i kryejnë vetëm me marrëveshje të përbashkët.

Me qëllim që të evitohen erozione dhe ndryshimet në brigjet e lumenjve e të përrrenjve gjatë rrjedhjes së të cilëve kalon vija e kufirit të përbashkët, të dy palët janë dakord, që të mos priten pemët, shkurret ose pyjet në zonat e tyre respektive.

#### Neni 5

Të gjitha piramidat kufitare, të ndërmjetme dhe shenjat e tjera kufitare të dëmtuara, të zhdukura ose të zhvendosura, do të rindërtohen ose riparohen në marrëveshje dhe në praninë e përfaqësuesve të të dy palëve, duke iu përmbajtur tërësisht të dhënave ekzistuese gjeodezike dhe sipas dimensioneve, formës dhe cilësisë të caktuara nga Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve të viteve 1922-1925 (shtojca nr.1 e protokollit të Firences).

Stemat, inicialet dhe shenjat e tjera në piramidat kufitare do të shënohen me bojërat përkatëse e në përputhje me emërtimet zyrtare të dy shteteve.

#### Neni 6

Rindërtimi dhe riparimi i piramidave kufitare, piramidave të ndërmjetme dhe i shenjave të tjera kufitare, si dhe pastrimi i vijës së kufirit 3 m nga pemët e shkurret, nga secila palë kontraktuese do të kryhet periodikisht çdo 5 vjet duke filluar nga riparimi dhe rindërtimi i parë i shenjave kufitare, e cila do të kryhet në afatin prej 3 vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 7

Për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje, palët në marrëveshje do të formojnë komisionin kryesor të përbashkët shqiptaro-malazez për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave kufitare (në tekstin e mëposhtëm: Komisioni i përbashkët), i cili ka këto detyra:

1. Propozon para qeverive të tyre për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe detyrat që dalin nga protokollat dypalëshe.

2. Shqyrton gjendjen në të cilën ndodhen piramidat kufitare dhe shenjat e tjera kufitare në bazë të informacioneve të paraqitura dhe merr masa për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

3. Mbikëqyr punimet për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave kufitare, piramidave të ndërmjetme dhe shenjave të tjera kufitare të zhdukura, zhvendosura dhe të dëmtuara, si dhe pastrimin nga pemët e shkurret e vijës së kufirit 3 m nga secila anë e tij.

4. Përgatit udhëzime teknike për grupe teknike të përbashkëta të punës.

5. Mbikëqyr veprimtarinë e grupeve teknike të përbashkëta të punës, shqyrton dhe zgjidh të gjitha çështjet e pa zgjidhura nga ana e tyre për probleme të saktësimit të vijës së kufirit.

#### Neni 8

Komisionin e përbashkët e përbëjnë 8 anëtarë, në përbërje të të cilit çdo palë emëron nga 4 anëtarë, nga të cilët njëri është kryetar i pjesës së vet të komisionit të përbashkët. Emrat e kryetarëve të secilës palë kontraktuese do të shkëmbehen në rrugë diplomatike 15 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Komisioni mund të ketë deri në 4 vetë si personel specialistë nga secila palë.

Komisioni i përbashkët do të fillojnë nga puna menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Data e saktë dhe vendi i takimit të parë të komisionit të përbashkët do të përcaktohet në rrugë diplomatike.

## Neni 9

1. Komisioni i Përbashkët do të mbajë takime të rregullta një herë çdo 3 vjet, me radhë, në territorin shqiptar dhe malazez.

2. Takimet e jashtëzakonshme të komisionit, do të mbahen me kërkesën e kryetarit të njëjës apo palës tjetër.

3. Kryetari i komisionit të përbashkët, në raste të posaçme, kanë të drejtë të marrin vendime mbi mbajtjen e takimit në Shqipëri ose Mal të Zi, pavarësisht nga radha.

4. Për sigurimin e pjesëmarrjes së anëtarëve të komisionit të përbashkët, personelit specialist, si dhe të anëtarëve të grupeve teknike të përbashkëta të punës, përgjegjës është ai shtet në territorin e të cilit mbahet takimi ose kryhen punimet.

5. Për kryerjen e detyrave të ngarkuara, anëtarëve të komisionit të përbashkët, personeli specialist, si dhe grupeve teknike të përbashkëta të punës, do t'u jepet ndihmë nga ana e organeve të vendit ku kryhen punimet.

## Neni 10

Për riparimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e piramidave dhe pastrimin e vijës së kufirit shtetëror, si dhe të shenjave notuese në liqenin e Shkodrës, komisioni i përbashkët, do të formojë dy grupe teknike të përbashkëta pune.

Anëtarët e grupeve teknike të përbashkëta të punës do të përbëhen nga 3 vetë, nga secila palë kontraktuese, nga të cilët njëri, topograf/gjeodezist, emërohet përgjegjës. Për kryerjen e punimeve në kufi, grupet e përbashkëta do të kenë personel fuqi punëtore.

Grupet teknike të përbashkëta të punës do të punojnë sipas seksioneve kufitare të parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe do të kryejnë detyrat që u caktohen nga komisioni i përbashkët.

## Neni 11

Gjatë kohës së kryerjes së punimeve në kufi, patrullat kufitare do të sigurojnë mbrojtjen dhe kryerjen e punimeve pa pengesa. Personat që kryejnë punimet nuk duhet të jenë të armatosur.

## Neni 12

Pala shqiptare do të përballojë me shpenzimet e veta mirëmbajtjen dhe riparimin e shenjave notonjëse (bova) nr.11,12,13,14,15,16,17,18,19,20 dhe 21 e kolonën e sinjalit ndriçonjës, te piramida A1-11.

Pala malazeze do të përballojë me shpenzimet e saj shenjat notonjëse nr.1,2,3,4,5,6,7,8,9 dhe 10 e kolonën e sinjalit ndriçonjës, te piramida A1-10 në liqenin e Shkodrës.

## Neni 13

Në rast se ndonjë nga piramidat kufitare ose shenjat e tjera kufitare (shenjë notuese) do të shkatërrohet, zhduket dhe dëmtohet në mënyrë të konsiderueshme dhe është e nevojshme të riparohet menjëherë për arsye të rëndësisë së vendit (vendkalim kufitar, rrugë, kthesë kufiri etj.), është detyrë e asaj pale që do të kujdeset për atë pjesë të sektorit që t'i njoftojë organet kufitare të palës tjetër, dhe në pajtim me të të kryejë riparimin e piramidës kufitare ose të shenjave të tjera kufitare.

## Neni 14

Për të gjitha piramidat ose shenjat kufitare të reja që mund të vendosen në vijën e kufirit do të bëhet dokumentacioni i ri topografik/gjeodezik përkatës, sipas modeleve të përcaktuara, nga Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve të viteve 1922-1925 dhe sipas protokollit të Firences të vitit 1926.

#### Neni 15

Në rast se do të ketë mospërputhje midis hartës dhe teksteve do të merret gjithmonë për bazë teksti me përshkrimin më të detajuar të vijës së kufirit që është bërë për çdo piramidë kufitare nga ana e Komisionit Ndërkombëtar, të viteve 1922-1925 e konfirmuar me protokollin e Firences të vitit 1926.

#### Neni 16

Secila palë e komisionit kryesor të përbashkët shqiptaro-malazez disponon vulë, forma dhe përmbajtja e së cilës janë caktuar në përputhje me legjislacionin e brendshëm të secilës palë.

#### Neni 17

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje ndërpritet veprimi i Konventës midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë mbi ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rindërtimin e piramidave kufitare, piramidave të ndërmjetme dhe shenjat e tjera kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro-jugosllav të datës 16 gusht 1956 për pjesën në të cilën përfshihet kufiri shtetëror shqiptaro-malazez dhe Konventa midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative të Jugosllavisë mbi ruajtjen dhe mirëmbajtjen e instalimeve të sinjaleve ndriçonjëse bregore e notonjëse dhe të shenjave notonjëse me anën e të cilave është përcaktuar kufiri shtetëror shqiptaro-jugosllav në ujërat e liqeneve të Shkodrës, Pogradecit (Ohrit) dhe Prespës, më 16 nëntor 1955 për pjesën që përfshihet kufiri shtetëror shqiptaro-malazez.

#### Neni 18

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën kur palët njoftojnë njëra-tjetrën në rrugë diplomatike për përmbushjen e kërkesave të tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Marrëveshja nënshkruhet për një kohë të pacaktuar dhe shfuqizimi i saj bëhet 6 muaj nga dita kur njëra nga palët në marrëveshje e anulon atë në rrugë diplomatike.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Podgoricë më 6.11.2009 në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, malazeze dhe angleze duke pasur të tri tekstet të njëjtën vlerë. Në rast paqartësie në interpretim epërsi do të ketë teksti në anglisht.

**LIGJ**  
**Nr.10 214, datë 21.1.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË IRLANDËS PËR SHMANGIEN E  
TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMIN  
MBI TË ARDHURAT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Irlandës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6392, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË IRLANDËS PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE  
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Irlandës, me dëshirën për të përfunduar një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Personat për të cilët zbatohet Marrëveshja**

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat të cilët janë rezidentë në një ose në të dy shtetet kontraktuese.

Neni 2

**Tatimet për të cilat zbatohet Marrëveshja**

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat, të vendosura në emër të një shteti kontraktues ose të autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato janë vendosur.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, ose elemente të të ardhurave, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme.

3. Tatimet ekzistuese, për të cilat zbatohet Marrëveshja, janë veçanërisht:

a) në rastin e Shqipërisë:

i) tatimet e të ardhurave;

ii) tatimi i korporatës; dhe

iii) tatimi i fitimeve kapitale,

në vijim të referuara si “tatimet shqiptare”;

b) në rastin e Irlandës:

i) tatimet e të ardhurave;

ii) tatimi i korporatës; dhe

iii) tatimi i fitimeve kapitale,

në vijim të referuara si “tatimet irlandeze”.

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëjtë ose në thelb të ngjashëm, që është vendosur pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre mbi tatimet.

### Neni 3

#### **Përkufizime të përgjithshme**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore.

b) Termi “Irlandë” përfshin çdo hapësirë jashtë ujërave territoriale të Irlandës, që ka qenë ose mund të përcaktohet më pas në bazë të ligjeve të Irlandës në lidhje me zonën ekonomike ekskluzive dhe shelfin kontinental, si një hapësirë brenda së cilës Irlanda mund të ushtrojë ato të drejta sovraane dhe juridiksion që janë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

c) Termat “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” nënkuptojnë Irlandën ose Shqipërinë, siç e kërkon konteksti.

d) Termi “person” nënkupton një individ, shoqëri dhe çdo grup tjetër personash.

e) Termi “shoqëri” nënkupton çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore.

f) Termat “sipërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “sipërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një sipërmarrje të drejtuar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një sipërmarrje të drejtuar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues.

g) Termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje, që e ka vendin e saj të menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveç rasteve kur anija ose avioni operohen vetëm midis vendndodhjeve në shtetin tjetër kontraktues;

h) Termi “shtetas” nënkupton:

i) çdo individ që ka kombësinë ose shtetësinë e një shteti kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që e marrin statusin si të tillë nga ligjet në fuqi në një shtet kontraktues.

i) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në rastin e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të autorizuar nga Ministria e Financave;

ii) në rastin e Irlandës, komisionerët e të ardhurave ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar.



2. Përsa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur atë kohë sipas ligjit të atij shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje, ku çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

#### Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje termi “rezident i një shteti kontraktues” nënkupton çdo person, i cili sipas ligjeve të atij shteti u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që u nënshtrohen tatimeve në atë shtet, në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në atë shtet.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dy shtetet kontraktues, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike) ;

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka vendqëndrim të zakonshëm;

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit, shtetas i të cilit ai është;

d) nëse është shtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dy shteteve kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv.

#### Neni 5 **Njësia e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “njësi e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “njësi e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Termi “njësi e përhershme”, gjithashtu përfshin:

a) Një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me të, por vetëm kur ky shesh, projekt ose aktivitet vazhdon për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë muaj, në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës; dhe

b) Dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm

kur aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që përbëjnë më shumë se gjashtë muaj në çdo periudhë dymbëdhjetëmuajore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës.

4. Një person që kryen aktivitete jashtë kufijve në një shtet kontraktues në lidhje me kërkimin ose shfrytëzimin e shtratit detar dhe nëntokën dhe burimet e tyre natyrore që gjenden në atë shtet kontraktues konsiderohet të zhvillojë biznes nëpërmjet një njësie të përhershme në atë shtet kontraktues.

5. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “njësi e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash, që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash, që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të vazhimit nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

6. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 7, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka, si edhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç rasteve kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 5, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit njësi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

7. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë njësi të përhershme në një shtet kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre.

8. Thjesht fakti që një shoqëri, e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një njësie të përhershme ose ndryshe), nuk tregon që një prej këtyre shoqërive është njësi e përhershme e shoqërisë tjetër.

## Neni 6

### **Të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme**

1. Të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që gjenden në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë plotësuese të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjisllacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet, barkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen, gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të përdorura për realizimin e shërbimeve personale të pavarura.

#### Neni 7

### **Fitimet nga biznesi**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznesin si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër, por vetëm për ato që i takojnë asaj njësie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen njësi e përhershme e së cilës ajo është, në secilin shtet kontraktues do t'i atribuohen asaj njësie të përhershme.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një njësie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të njësisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të bëra në shtetin në të cilin ndodhet njësi e përhershme ose diku tjetër.

4. Për sa kohë që është e zakonshme në një shtet kontraktues të përcaktojë fitimet që i atribuohen një njësie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë shtet kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të taten nga kjo ndarje, siç mund të jetë e zakonshme, megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë fitim nuk i atribuohet një njësie të përhershme për shkak vetëm të blerjes nga ajo njësi e përhershme e mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen njësisë së përhershme përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave ose fitime që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

### **Transporti ndërkombëtar**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv.

2. Për qëllime të këtij neni, fitimet e nxjerra nga operimi i anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar përfshijnë fitimet që rrjedhin nga dhënia me qira e anijeve ose avionëve, nëse këto anije ose avionë operohen në trafikun ndërkombëtar ose nëse këto fitime nga qiraja kanë të bëjnë me fitime të tjera të përshkruara në paragrafin 1.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

4. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të një ndërmarrjeje transporti është në bordin e një anijeje, ai konsiderohet të gjendet në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet porti i regjistrimit të anijes ose nëse nuk ka port regjistrimi, në shtetin kontraktues në të cilin operatori i anijes është rezident.

Neni 9  
**Ndërmarrjet e asociuara**

1. Në rastet kur:

a) Një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues, ose

b) Të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues, dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në lidhje me marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim, që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tathet sipas rregullave.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti dhe taton sipas rregullave fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatuar në atë shtet tjetër dhe kur fitimet e përfshira janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultohen me njëra-tjetrën.

Neni 10  
**Dividendët**

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tathohen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tathohen gjithashtu në shtetin kontraktues, në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një firmë (e ndryshme nga një ortakëri) që zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë të paktën 25 për qind të kapitalit të firmës që paguan dividendët;

b) 10 për qind të sasisë bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese caktojnë mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2, dividendët që kanë origjinën në një shtet kontraktues dhe i paguhen qeverisë së shtetit tjetër kontraktues, përjashtohen nga tatimet. Termi "Qeveri", përfshin:

a) Në rastin e Shqipërisë:

i) Bankën Qendrore të Shqipërisë; dhe

ii) një organ ligjor ose çdo institucion që zotërohet plotësisht ose kryesisht nga Qeveria e Shqipërisë, siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

b) Në rastin e Irlandës:

i) Bankën Qendrore të Irlandës;

ii) Agjencinë Kombëtare të Menaxhimit të Thesarit;

iii) Fondin Kombëtar të Rezervës së Pensioneve; dhe

iv) një organ ligjor ose çdo institucion që zotërohet plotësisht ose kryesisht nga Qeveria e Irlandës, siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

4. Termi “dividend” siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe të ardhura nga të drejta të tjera të shoqërisë, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor, si të ardhurat nga aksionet, nga ligjet e shtetit në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën janë paguar dividendët është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazën fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

6. Kur një shoqëri e cila është rezidente e një shteti kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën janë paguar dividendët, është efektivisht e lidhur me njësinë e përhershme ose një bazë fikse të vendosur në atë shtet tjetër, dhe as nuk do t'i nënshtrojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

## Neni 11

### Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të jetë i tatuashëm në shtetin kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 7 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese caktojnë me marrëveshje reciproke mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi i përmendur në paragrafin 1 do të jetë i tatuashëm vetëm në shtetin kontraktues në të cilin marrësi është rezident nëse pronari përfitues i interesit është rezident i atij shteti dhe:

a) Në rastin e Shqipërisë:

i) Bankën Qendrore të Shqipërisë; dhe

ii) një organ ligjor ose çdo institucion që zotërohet plotësisht ose kryesisht nga Qeveria e Shqipërisë, siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

b) Në rastin e Irlandës:

i) Bankën Qendrore të Irlandës;

ii) Agjencinë Kombëtare të Menaxhimit të Thesarit;

iii) Fondin Kombëtar të Rezervës së Pensioneve; dhe

iv) një organ ligjor ose çdo institucion që zotërohet plotësisht ose kryesisht nga Qeveria e Irlandës, siç mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese.

c) Është një institucion financiar ose interesi është paguar nga një institucion financiar.

d) Nëse interesi paguhet në lidhje me qënien në borxh, që rrjedh si rezultat i një shitjeje me kredi të një pajisjeje, malli ose shërbimi.

e) Është një pension që përjashtohet nga tatimi i të ardhurave nga interesat.

4. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet

ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë primet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit, si dhe të gjitha të ardhurat e tjera që trajtohen si të ardhura nga para të dhëna hua sipas ligjeve të shtetit në të cilin dalin të ardhurat, por nuk përfshijnë asnjë të ardhur që trajtohet si dividend sipas nenit 10. Gjobat për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllimet e këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi, është efektivisht i lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose 14.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues, kur paguesi është vetë shteti, një nënndarje politike e tij, një autoritet lokal ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një njësi të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo njësi e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet njësia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë nëpërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 12

### Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që lindin në një shtet kontraktues dhe të përfituara në pronësi nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues, mund të tatonen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa të licencave mund të tatonen gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin ato lindin dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 7 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese caktojnë me marrëveshje reciproke mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “tarifat e licencave” siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra në lidhje me përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore (duke përfshirë filma kinematografikë dhe regjistrimet në shirita për transmetim radiofonik ose televiziv), çdo patentë, markë tregtare, projekt ose model, plan, formulë sekrete ose proces, ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen tarifat e licencave, është e lidhur efektivisht me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

5. Tarifat e licencave konsiderohen të lindin në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan tarifat e licencave, rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues njësi të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën është shkaktuar detyrimi për të paguar tarifat e licencave dhe këto tarifa përballohen nga kjo njësi e përhershme ose vend fiks, atëherë këto tarifa do të konsiderohen të lindin në shtetin kontraktues në të cilin është vendosur njësia e përhershme ose vendi fiks.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumat e tarifave të licencave, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalojnë shumën e cila do të ishte rënë dakord nga pagesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 13

#### **Fitimet e kapitalit**

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, për qëllim të kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj njësie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose të kësaj baze fikse, mund të taten në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve të operuar në trafikun ndërkombëtar, ose pronës së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve, ose avionëve do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e përfuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i:

a) aksioneve të ndryshme nga aksionet e kuotuarat në një bursë të njohur, që marrin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në shtetin tjetër kontraktues; ose

b) një interes në një ortakëri ose trust që merr më shumë se 50 për qind të vlerës së tij drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone, të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

6. Dispozitat e paragrafit 5 nuk cenojnë të drejtën e një shteti kontraktues për të vjelë, sipas ligjit të vet, një tatim mbi fitimet nga tjetërsimi i çdo prone që përftohet nga një individ që është rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe ka qenë rezident i shtetit të parë në çdo kohë gjatë pesë viteve para tjetërsimit të pronës.

#### Neni 14

#### **Shërbimet personale të pavarura**

1. Të ardhurat që rrjedhin nga një individ, i cili është rezident i një shteti kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç rrethanave të mëposhtme kur këto të ardhura mund të taten edhe në shtetin tjetër kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse që i vihet atij rregullisht në dispozicion në shtetin tjetër kontraktues për qëllim të kryerjes së aktiviteteve të tij; në atë rast vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj bazë fikse mund të taten në atë shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër kontraktues është për një periudhë ose periudha që arrijnë apo tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; në atë rast, vetëm ajo sasi të ardhurash që rrjedhin nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose didaktike, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, auditeve dhe kontabilistëve.

#### Neni 15

#### **Shërbimet personale të varura**

1. Në bazë të dispozitave të neneve 16, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përftohet atje mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përftuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, do të jetë i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) marrësi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, e cila fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe;

c) shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm ose bazë fikse, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni të operuar në trafikun ndërkombëtar nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues, mund të tatohet në atë shtet kontraktues.

#### Neni 16

#### **Tarifat e drejtuesve**

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve të një shoqërie, e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

#### Neni 17

#### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në rolin e subjektit argëtues, si: artist teatri, filmi, radioje ose televizioni, ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale të ushtruara në këtë mënyrë në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një subjekt argëtues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti, por nga person tjetër, ato të ardhura pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e subjektit argëtues apo sportistit.

#### Neni 18

#### **Pensionet**

1. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe pagesa të ngjashme të paguara një rezidenti të një shteti kontraktues, duke marrë parasysh punësimin e shkuar, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Termi “pension vjetor” është një shumë e caktuar që paguhet periodikisht në kohë të caktuara gjatë jetës ose gjatë një periudhe të përcaktuar, ose të përcaktueshme në kohë në bazë të një



detyrimi për të bërë pagesa si kundërvleftë e shpërblimit të drejtë dhe të plotë në para ose në vlerë monetare.

#### Neni 19 **Shërbimi qeveritar**

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, përveç pensione, të paguara nga një shtet kontraktues ose një autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet, ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky shpërblim do të jetë i tatueshëm vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individ është rezident i atij shteti dhe që:

i) një shtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2.a) Pensionet e paguara nga ose prej fondeve të krijuara nga një shtet kontraktues ose autoritet lokal i tij për një individ mbi shërbimet e kryera në atë shtet, ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse individ është rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të zbatohen për rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, dhe pensionet, në lidhje me shërbimet e kryera mbi një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose autoritet lokal i tij.

#### Neni 20 **Studentët dhe stazhierët**

Nëse një student ose stazhier biznesi, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues, rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, asnjë pagesë që merret për qëllimet e mbështetjes ekonomike, edukimit ose trajnimit të tij nuk do të taten në atë shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

#### Neni 21 **Të ardhurat e tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajtuara në nenet pararendëse të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur në të dhe e drejta ose prona në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

#### Neni 22 **Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

1. Në Irlandë:

Në pajtim me dispozitat e ligjeve të Irlandës në lidhje me zbritjen si kredi kundrejt tatimit irlandez të tatimit të pagueshëm në një territor jashtë Irlandës (që nuk cenon parimin e përgjithshëm):

a) Tatimi shqiptar i pagueshëm sipas ligjeve të Shqipërisë dhe në pajtim me këtë Marrëveshje, drejtpërdrejt ose me zbritje, mbi fitimet, të ardhurat ose fitimet nga burimet brenda

Shqipërisë (duke përjashtuar në rastin e një tatimi mbi dividendin të pagueshëm në lidhje me fitimet nga të cilat paguhet dividendi) konsiderohet si kredi kundrejt çdo tatimi irlandez të llogaritur, duke iu referuar të njëjtat fitimeve ose të ardhurave në lidhje me të cilat llogaritet tatimi shqiptar.

b) Në rastin e një dividendi të paguar nga një shoqëri që është rezidente e Shqipërisë një shoqërie që është rezidente e Irlandës dhe që kontrollon drejtpërdrejt ose jo 5 për qind ose më shumë të fuqisë votuese në shoqërinë që paguan dividendin, kredia merr parasysh (përveç tatimeve shqiptare të kreditueshme sipas dispozitave të nënparagrafit (a) të këtij paragrafi tatimin shqiptar të pagueshëm nga shoqëria në lidhje me fitimet, nga të cilat është paguar ky dividend.

## 2. Në Shqipëri:

Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të taten në Irlandë, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin irlandez të paguar mbi ato të ardhura. Megjithatë, kjo zbritje nuk kalon atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat që llogaritet para se të bëhet zbritja, që u përket, sipas rastit, të ardhurave që mund të taten në Irlandë.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2, fitimet, të ardhurat dhe fitimet e kapitalit në pronësi të një rezidenti të një shteti kontraktues që mund të taten në shtetin tjetër kontraktues në pajtim me këtë Marrëveshje konsiderohet të rrjedhë nga burime në atë shtet tjetër kontraktues.

4. Nëse në pajtim me një dispozitë të Marrëveshjes të ardhurat e përftuara nga një rezident i një shteti kontraktues janë të përjashtuara nga tatimi në atë shtet, ky shtet, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

5. Nëse sipas një dispozite të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat ose fitimet lirohen plotësisht ose pjesërisht nga tatimi në një shtet kontraktues dhe, sipas ligjeve në fuqi në shtetin tjetër kontraktues, një individ, në lidhje me këto të ardhura ose fitime, i nënshtrohet tatimit duke iu referuar shumës që i kthehet ose merret në atë shtet tjetër dhe jo duke iu referuar shumës së plotë, dhe përjashtimi që lejohet sipas kësaj Marrëveshjeje në shtetin e parë zbatohet vetëm për atë pjesë të të ardhurave ose fitimeve që kthehet ose merret në atë shtet tjetër.

## Neni 23

### Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit të shtetit tjetër kontraktues ose çdo kërkese në lidhje me të, që ndryshon ose është më e rreptë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse ndaj të cilave shtetasit e atij shteti tjetër nënshtrohen ose mund të nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, kjo dispozitë zbatohet edhe ndaj personave, të cilët nuk janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

2. Tatimi mbi një njësi të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyruese për një shtet kontraktues për t'u dhënë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues çdo zbritje financiare personale, lehtësira dhe ulje për qëllime tatimore, duke marrë parasysh statusin civil ose përgjegjësitë familjare, të cilat u jep vetëm rezidentëve të vet.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifata e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë.

4. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi në shtetin e përmendur më parë dhe asnjë kërkese në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rreptë se tatimi dhe kërkesat e ngjashme të cilave mund t'i nënshtrohen ndërmarrjeve të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

## Neni 24

### Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë

1. Kur një person çmon se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktues rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 24, mund t'ia paraqesë autoriteteve kompetente të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim në mospajtim me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse mendon që kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje. Çdo Marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes. Ata gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në raste të cilat nuk janë parashikuar në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëra-tjetrën në mënyrë të drejtpërdrejtë, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

## Neni 25

### Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë informacionin e parashikuar të nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e caktuar në emër të shteteve kontraktuese, ose të nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas atyre nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë në bazë të paragrafit 1 nga një shtet kontraktues trajtohet konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve mbi tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose moskryerjen sa më sipër. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në procedime gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të një shteti tjetër kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përfutueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administrimit në atë ose një shtet tjetër kontraktues;

c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues zbaton masat e veta për mbledhjen e informacionit për të përftuar informacionin e kërkuar, edhe nëse shteti tjetër mund të mos e kërkojë këtë informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi i parashikuar në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen për të lejuar një shtet kontraktues për të mos dhënë informacion thjesht, sepse ai nuk ka interes të brendshme për këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues për të mos dhënë informacion thjesht, pasi informacioni zotërohet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar ose person që vepron në një agjenci ose një cilësi besimi, ose pasi ai ka të bëjë me interesat e pronësisë së një personi.

#### Neni 26

#### **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore**

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të cenojë privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

#### Neni 27

#### **Hyrja në fuqi**

1. Secili shtet kontraktues njofton tjetrin mbi përfundimin e procedurës së kërkuar nga ligji i vet për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nga këto njoftime dhe pas kësaj ka fuqi:

a) Në Shqipëri:

i) Në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për të ardhurat e përfuara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik, pas vitit në të cilin hyn në fuqi Marrëveshja;

ii) Në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat, për tatimet që vendosen për çdo vit tatimor që fillon në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik, pas vitit në të cilin hyn në fuqi Marrëveshja;

b) Në Irlandë:

i) Në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe tatimet mbi fitimet e kapitalit për një vit nga vlerësimi që fillon në ose pas ditës së parë të janarit në vitin kalendarik, pas vitit në të cilin ka hyrë në fuqi marrëveshja;

ii) Në lidhje me tatimet mbi shoqëritë, për çdo vit financiar që fillon në ose pas ditës së parë të janarit në vitin kalendarik pas vitit në të cilin ka hyrë në fuqi kjo Marrëveshje.

#### Neni 28

#### **Prishja e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të prishet nga një palë kontraktuese. Secila palë kontraktuese mund ta prishë kontratën në çdo moment pas pesë vjetësh nga data në të cilën Marrëveshja ka hyrë në fuqi me kusht që gjashtë muaj më parë të jetë dhënë njoftim me shkrim për prishjen e Marrëveshjes nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Në këtë rast, Marrëveshja pushon së pasuri fuqi:

a) Në Shqipëri:

i) Në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për të ardhurat e përfuara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin jepet njoftimi;

ii) Në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat, për tatimet që vendosen për çdo vit tatimor që fillon në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin jepet njoftimi.

b) Në Irlandë:

i) Në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe tatimet mbi fitimet e kapitalit për çdo vit nga vlerësimi që fillon në ose pas ditës së parë të janarit pas datës në të cilën periudha e specifikuar skadon në njoftimin e prishjes së Marrëveshjes;

ii) Në lidhje me tatimet mbi shoqëritë, për çdo vit financiar që fillon në ose pas ditës së parë të janarit pas datës në të cilën periudha e specifikuar skadon në njoftimin e prishjes së Marrëveshjes.

Në dëshmi sa më sipër, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, Tiranë më 16 tetor 2009, në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dy tekstet janë njëjloj autentikë.

### **KËRKESË**

Shtetasi Izija Latollari lindur dhe banues në Barçallëk të rrethit Pogradec, kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të tij Alket Latollari.

**KËRKUESI**  
**Izija Latollari**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE .....	240 lekë
KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL .....	410 lekë
KODI I PUNËS .....	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK .....	55 lekë
KODI I FAMILJES .....	270 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE .....	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 12.2.2010  
Doli nga shtypi më 15.2.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT  
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë